



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 61, datë 24. 12. 2021

“SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PASURISË SË PALUAJTSHME (Zyra), PRONË PRIVATE, QË DO TË PREKEN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE ADMINISTRATIVE, NGA BASHKIA SKRAPAR”


Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 24. 12. 2021, pasi mori në shqyrtim projektaktin e hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1.2, germa “b”, neni 54, gërma “e”, Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive private për interes publik”, i ndryshuar, VKM- në Nr. 127, datë 23.03.2000 “Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, VKM- në Nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, VKM- në Nr.89, datë 03.02.2016, “Për miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë”

VENDOSI:

1. Miratimin e procedurës së shpronësimit për interes publik të pronarit të pasurisë të paluajtshme (zyra), pronë private, që do të preken për ushtrimin e funksioneve administrative, nga Bashkia Skrapar
2. Pronari i pasurive të paluajtshme që shpronësohet, të kompesohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën më poshtë.

Emri i pronarit	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja që shpronësohet	Vlera financiare	Shënime
Qemal Hamit Duro	4/92-N1	Zyra	1420	84 m ²	3 150 000	

3. Vlera financiare e shpronësimit për interes publik prej 3 150 000 (tre milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Skrapar , në zërin “shpronësime”.



4.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim
Taksave

5.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015
"Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 13 vota pro , votë kundër – s'ka, 1- votë abstenim .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

